



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE  
BORDI**

**VENDIM**

**Nr. 114, datë 25.07.2025**

**PËR  
MIRATIMIN E RIEMËRIMIT NË POZICIONIN E ANËTARIT TË KËSHILLIT TË  
ADMINISTRIMIT TË SHOQËRISË “CREDINS INVEST” SH.A. - SHOQËRI  
ADMINISTRUESE E FONDEVE TË PENSIONIT PRIVAT DHE SIPËRMARRJEVE TË  
INVESTIMEVE KOLEKTIVE**

Në zbatim të pikës 22, të nenit 14, të ligjit nr. 9572, datë 3.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, ligjit nr. 76/2023 “Për fondet e pensionit privat”, ligjit nr. 56/2020 “Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive”, rregullores nr. 112, datë 31.08.2020 “Për licencimin dhe rregullat shtesë të licencimit të shoqërive administruese të fondeve, depozitarëve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive, licencimin dhe regjistrimin e sipërmarrjeve të investimeve kolektive të themeluara në Republikën e Shqipërisë”, si dhe rregullores nr. 1, datë 31.01.2024, “Për licencimin dhe rregullat shtesë të licencimit të shoqërisë administruese të fondeve të pensionit privat dhe depozitarit të fondeve të pensionit privat të themeluara në Republikën e Shqipërisë”, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

**V E N D O S I:**

- 1. Miratimin e riemërimit të z. Egi Santo, në pozicionin e anëtarit të Këshillit të Administrimit të shoqërisë “Credins Invest” sh.a. - shoqëri administruese e fondeve të pensionit privat dhe sipërmarrjeve të investimeve kolektive, deri në datë 24.08.2028.**
- 2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.**

**Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.**

**KRYETAR**

**Saimir TOLA**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV**

**Mimoza KAÇI**